

# RAPORTI TEKNIK I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

## PËR AKTIVITETIN

### “LINJË PËRPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT MEDICINALE”

#### NJËSIA ADMINISTRATIVE BRADASHESH, BASHKIA ELBASAN

Studimi përfshihet në Shtojcën II, “Projekte që i nënshtrohen procedurës paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis Pika 7: Industria ushqimore . b) Prodhimi, përpunimi dhe paketimi dhe i produkteve shtazore dhe bimore;



**POROSITËS:** BIO FLORES “ SHPK”, NIPT *L93309203B*

**VENDNDODHJA:** Bashkia Elbasan, Njësia Administrative Bradashesh, Fshati Fshati Kusarth, Lagjja Gjatallareve, Rruga Kadri Hoxha, Zona kadastrale nr 2346, Nr pasurie 390/7-ND-ND.

**HARTOI RAPORTIN TEKNIK TE VNM-se**

**AK STUDIO SHPK**

**NIPT *L81927016I***



**TIRANE, 2021**

**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**

**PËRMBAJTJA E LËNDËS**

<b>1.1. Raporti teknik i aktivitetit të propozuar.....</b>	<b>2</b>
<b>a.Qëllimi i aktivitetit të propozuar.....</b>	<b>3</b>
<b>b. Planimetria e vendodhjes së aktivitetit “Linjë Përpunimi dhe Prodhimi i Çajit të Ftohtë nga Bimët Medicinale”, Fshati Kusarth, Njësia Administrative Bradashesh, Bashkia Elbasan, koordinatat sipas sistemit GAUS KRYGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga aktiviteti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë.....</b>	<b>4</b>
<b>c.Informacion për qendrat e banuara në zonën ku propozohet të zbatohet aktiviteti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja, si dhe përcaktimi i qeverisjes.....</b>	<b>6</b>
<b>ç.Skicat dhe planimetritë e objektit dhe strukturave për aktivitetin, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objektit dhe strukturave të aktivitetit “Linjë Përpunimi dhe Prodhimi i Çajit të Ftohtë nga Bimët Medicinale”.....</b>	<b>20</b>
<b>d. Përshkrimi i proceseve ndërtimore dhe teknologjike, produktet e aktivitetit.....</b>	<b>22</b>
<b>dh. Informacion për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimin e ujrave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja.....</b>	<b>34</b>
<b>e. Programi për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e aktivitetit, kohën e mundëshme të përfundimit të funksionit të aktivitetit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionit të aktivitetit.....</b>	<b>34</b>
<b>ë. Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji).....</b>	<b>35</b>
<b>f. Informacion për lidhjet e mundëshme të aktivitetit me projekte të tjera ekzistuese përreth/ pranë zonës së aktivitetit.....</b>	<b>35</b>
<b>g. Informacion për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së aktivitetit dhe teknologjisë që do të përdoret.....</b>	<b>35</b>
<b>gj.Të dhëna për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasinë e ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyra e sigurimit të tyre .....</b>	<b>36</b>
<b>h. Aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e aktivitetit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.; .....</b>	<b>36</b>
<b>i.Informacion për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për aktivitetin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin /licensimin e aktivitetit.....</b>	<b>36</b>
<b>j.Kopje të lejeve, autorizimeve dhe licensave që disponon zhvilluesi për aktivitetin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra nga legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/autorizimin/licensimin e aktivitetit.....</b>	<b>37</b>

**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**

## **1.1. Raporti teknik i aktivitetit të propozuar**

Çaji është një pije e rëndësishme mijëra-vjeçare dhe ka qenë një pjesë e rëndësishme kulturore në shumë shtete të botës, si pjesë e ceremonive madhështore. Por çaji nuk është vlerësuar vetëm për shijen e mirë dhe për paraqitjen botërore por edhe për shkak të një sërë benefiteve të tjera.

Pijet e çajrave janë një treg ndërkombëtar në rritje, qoftë si çaj i ftohtë i bërë nga ekstrakti i çajit të zi, ose me ekstrakt pjeshke, dhe me aromatizues pjeshkën. pH e çajit sillet nga 2,5 në 4,0. Çaji i ftohtë njihet edhe si një pije popullore, ai mund të jetë i përzier me; sirup me shije të përbashkët duke përfshirë limon, pjeshkë, dhe qershi. Gjersa shumica e çajrave të ftohtë e marrin aromën e tyre nga gjethet e çajit (*Sinensis Camellia*), të tjerat çajra të fituara nga barishtet mund të përdorin aromatizues të tjerë për të krijuar një shije karakteristike të ndonjë lloji tjetër.

Shoqëria "BIO FLORES" shpk. e regjistruar në QKR më datë 09/09/2019 me NR. Nipti L93309203B, kërkon të ngrejë aktivitetin e saj për “Linjë Përpunimi dhe Prodhimi i Çajit të Ftohtë nga Bimët Medicinale” me qendër në fshatin Kusarth, Njësia Administrative Bradashesh, Bashkia Elbasan, në objektin e marrë me qera sipas kontratës Nr.1320, rep 571.12 kol. datë 08.10.2019. midis pronarit të objektit dhe shoqërisë që do të kryejë aktivitetin industrial ushqimor.

### **a. Qëllimi i aktivitetit të propozuar**

**Raporti Teknik i VNM** është hartuar për të dhëna të aktivitetit, të veprimtarisë prodhuese dhe të dhëna të zonës ku ngrihet objekti ku do të kryhet aktiviteti industrial ushqimor. Gjithashtu përmbajtja e raportit do të ndihmojë organet vendimarrëse dhe Shoqërinë "BIO FLORES" shpk. që të ruajë mjedisin përreth. Materiali i paraqitur nga grupi i punës përfshin matjet përkatëse të koordinatave të zonës ku ndodhet prona dhe fotografitë elektronike që i janë bërë objektit ekzistues, specifikimet teknike për aktivitetin prodhues të çajit të ftohtë, studimin gjeologjik të zonës, të dhëna për mjedisin dhe burimet ujore, relacioni për procesin teknologjik për prodhimin e çajrave nga bimët medicinale, si dhe problematikat të cilat janë pasqyruar në materialin për aktivitetin ekonomik të industrisë ushqimore që shoqëron aktivitetin. Pasi u pa i gjithë materiali i vënë në dispozicion nga investitori, cilësohet që aktiviteti, **ka për qëllim:**

- **Prodhimin e Çajrave të Ftohtë nga Bimët Medicinale me standarte bashkëkohore**
- **Zhvillimin e ekonomisë dhe industrisë ushqimore, rritja e rendimentit të prodhimeve industriale në Bashkinë Elbasan**
- **Futja sa më mirë në efikasitet dhe prodhimeve bio.**
- **Ngritjen e cilësisë së jetës së komunitetit që banon në Elbasan dhe zonat përreth saj.**
- **Zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor për qytetin e Elbasanit.**

Raporti Teknik i VNM për aktivitetin “Linjë Përpunimi dhe Prodhimi i Çajit të Ftohtë nga Bimët Medicinale”, është udhëhequr nga orientimet e mëposhtme:

- Rëndësia e funksionimit të plotë të këtij aktiviteti prodhues në funksion të industrisë ushqimore.
- Kërkesa dhe nevojat e popullsisë për përmirësimin e shërbimeve dhe prodhimeve çajrave bio.
- Pozicioni gjeografik i objektit ku do të realizohet aktiviteti industrial, pasuritë natyrore dhe humane të zonës si dhe vlerat e veçanta të tyre.
- Në identifikimin e ndikimeve negative dhe lokale.
- Në marrjen e masave zbutëse duke patur parasysh ruajtjen e interesave ekonomike dhe sociale të investimit në qytetin e Elbasanit.
- Në masat orjentuese për një zhvillim të qëndrueshëm të mjedisit në Bashkinë e Elbasanit ku do kryhet procesi prodhues.


**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**

Zona ku bën pjesë objekti është mbi ato pjesë të territorit të Bashkisë Elbasan me funksion të përzier dhe aktualisht, ka ndërhyrje në zhvillimin urban të zonës me ndërtime të reja, me karakter ekonomik, industri prodhuese ushqimore, magazina fruta - perime, shtëpi banimi, objekte 1-2-3 katëshe dhe shërbime në infrastrukturë. Për nga pikëpamja e sipërfaqeve ndërtimore objekti është mbitokësor 3 kat. Aktiviteti industrial do të realizohet në katin e parë të objektit. Ky objekt shërben mjaft mirë për aktivitetin ekonomik që kërkon të realizohet në këtë zonë.

**b) Planimetria e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë;**

Sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti “Linjë Përpunimi dhe Prodhimi i Çajit të Ftohtë nga Bimët Medicinale”, ndodhet rreth 2.51 km. larg nga qendra e Qytetit të Elbasanit, në krahun e djathtë të rrugës së vjetër nacionale Elbasan -Durrës, në Njësinë Administrative Bradashesh, në kryqëzimin e kësaj rruge me atë që lidh Fabrikën e Çimentos me rrugën nacionale në fshatin Kusarth. Zona ka funksion banimi, ekonomik dhe industrial dhe ndodhet pranë kodrave me ullinj të Njësisë Administrative Bradashesh.

Foto Nr. 05. Pozicioni i objektit ku do të kryhet aktiviteti “Linjë Përpunimi dhe Prodhimi i Çajit të Ftohtë nga Bimët Medicinale”, në Hartën ajrore.



Objekti është marrë me qera nga shoqëria "BIO FLORES" shpk. sipas kontratës Nr.1320, rep 571.12 kol. datë 08.10.2019. midis pronarit të objektit dhe shoqërisë që do të kryejë aktivitetin industrial ushqimor. Objekt i kësaj kontrate është dhënia me qira e katit të parë të objektit me sipërfaqe 246.2 m<sup>2</sup>, nga pasuria e palujtshme nr.390/7-ND, vol.5 fq. 215, zona kadastrale nr. 2346, lloji i pasurisë ndërtesë tre kat, me sipërfaqe totale 246 m<sup>2</sup>. Pronësia e qiradhënësit konfirmohet nëpërmjet çertifikatës së pronësisë, hartës treguese dhe kartelës, lëshuar datë 21.09.2019 nga ASHK. Pronësia e qiradhënësit është fituar në bazë të lejes së legalizimit nr.2578793, datë 17.04.2018.



**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**

Foto Nr. 06. Pozicioni i pronës në Hartën kadastrale




Foto Nr. 07 . Koordinatat e kufirit të pronës në projeksionin GAUS-KRYGER janë si më poshtë:



	Albanian 1986/Gauss Kruger Zone 4	KRGJSH
X1	4420375.703	504239.050
Y1	4553492.379	4552928.440
X2	4420390.315	504253.610
Y2	4553496.692	4552932.500
X3	4420387.918	504250.950
Y3	4553507.502	4552943.280
X4	4420372.895	504235.970
Y4	4553503.893	4552939.220

Tabela 01. Kufizimet e pronës Pasuria 390/7

Veri	390/5
Jug	390/7-29
Lindje	390/7- 7/1
Perëndim	390/7/1

**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**

Foto Nr.08-09. Pamje të gjendjes aktuale të pronës në zhvillim.



**Të dhëna mbi sipërfaqen e tokës që do të përdoret nga aktiviteti dhe funksionimi i tij.**

Sipërfaqja e tokës që do të përdoret për ativitetin industrial është në perëndim të qytetit të Elbasanit. Kjo pronë është e zënë komplet me objektin ekzistues 3 kat. Trualli është i sheshtë pa pjerrësi dhe ka lidhje direkt me rrugën nacionale dhe rrugët dytësore të Njësisë Administrative Bradashesh, Bashkia Elbasan.

**Përputhja e aktivitetit me plane të rregullimit territorial dhe zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar.**

Miratimi i këtij aktiviteti bëhet nga organet shtetërore dhe ato të organeve tatimore, pushtetit lokal të zonës dhe atij qëndror si dhe pa dyshim në përputhje me Planin e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Elbasan, Strategjisë për Zhvillimin Hapsinor dhe Ekonomisë në territorin e Elbasanit dhe në Qarkun Elbasan.

**c) informacionin për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti;**

**Njësia Administrative Bradashesh është pjesë e Bashkisë Elbasan.** Ajo ndodhet në pjesën qendrore të Shqipërisë, në perëndim të qytetit të Elbasanit, në fushën me të njëjtin emër. Relievi është tipik fushor e kodrinor i thyer, por me maja të buta. Kodrat ndodhen në krahun e majtë të përroit të Kushës me: Kodrat e Kusarhit, Balzës (ku shtrihet fabrika e Çimentos), Gurabardhit, Karakullakut (veshur me dushk), Kozanës, maja e Fungut, maja e Cirrumullit.

Në të djathtë të përroit të Kushës deri tek përroi i Kaliçovës ngrihet grupi i kodrave të Bradasheshit-Fikas (të veshura me ullinj e fiq) e të Shijonit. Grupi i fundit i kodrave është ai që fillon nga Balldreni – Jatesh – Shënmhill. Hidrografia përbëhet nga përroi i Kushës me degët e tij, përroi i Kalicovës etj. Territori i Njësisë Administrative Bradashesh ka burime nëntokësore, ujëmbledhëse. Në këtë territor ka dhe monumete të natyrës si:

**Njësia Administrative Bradashesh** përfshin 17 fshatra. Bradashesh, Balëz Lart, Balëz Poshtë, Kusarh, Kozan, Karakullak, Letan, Rrile, Shtemaj, Ulen, Katund i ri, Fikas, Patresh, Shënmëhill, Shingjon, Reçan, Gurabardhë. Popullsia sot numuron 12642 banorë. Shtrihet në një sipërfaqe prej 55,2 km<sup>2</sup>. Drejtimi kryesor i ekonomisë ka qenë prodhimi i drithrave të bukës dhe rritja e lopëve dhe të dheneve. Sipërfaqja e tokës bujqësore është 1600ha dhe sipërfaqja e pyjeve dhe kullotave është 2092 ha. Sot aty veprojnë 93 biznese. Ka 9 kopshte fëmijësh, 8 shkolla fillore, 7 shkolla 9-vjeçare. Popullsia e zonës është vendase, por ka të ardhur nga zona të tjera, sidomos nga malësia e Martaneshit. Është e banuar që në kohërat e vjetra dhe ka monumete kulture si: Stacioni At Quintum që është trakt i rrugës Egnatia, Manastiri i Gjon Vladimirit (i kohës bizantine), çezmja e

**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**

Kasinës, etj. Në këtë njësi administrative të Bashkisë Elbasan ka disa monumente kulture interesante dhe të bukura për t’u vizituar.

**Stacioni rrugor Ad – Quintum** ndodhet në fshatin Bradashesh. Është në gjendje të mirë për t’u vizituar dhe ndodhet buzë rrugës nacionale.

Foto Nr. 10-11. Pamje e Stacionit rrugor Ad Quintum-Pamje e Kishës së Shën Gjon Vladimirit



Ky stacion është ndërtuar në shekullin II të pas Krishtit përgjatë rrugës Egnatia për t’i shërbyer udhëtarëve. Ai përbën një kompleks së bashku me ninfeun të vendosur në një sipërfaqe katërkëndëshe 45 x 12 metra.

**Kisha e Shën Gjon Vladimirit** në fshatin Shëngjon. Në afërsi të rrugës Egnatia, në një nga degëzimet e saj që të çon në drejtim të Petrelës ndodhet Manastiri i Shën Gjonit. Gjon Vladimiri, princ i Krajës, i cili u vra në Prespë kundër bullgarëve më 4 Qershor 1016. Kisha është e vizitueshme dhe ndodhet 5 km nga Elbasani.

### **Ajri, uji, faktorët klimatikë, zhurmat etj.**

Qarku Elbasan shtrihet në zonën qendrore të Shqipërisë. Ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 3292 km<sup>2</sup> dhe një popullsi prej 433.244 banorë. Kufizohet në Veri dhe Veri-Perëndim me Qarkun e Tiranës, në Lindje dhe Jug-Lindje me Qarkun e Korçës, në Perëndim dhe Jug-Perëndim me Qarkun e Beratit.

Në përbërje të tij janë katër rrethe: Rrethi Elbasan, që është edhe qendra e këtij qarku, Rrethi Librazhd, Rrethi Peqin, Rrethi Gramsh. Nga ana administrative Qarku ka 7 bashki, dhe 386 fshatra. Shtrihet në fushën me të njëjtin emër, në krahun e djathtë të rrjedhës së mesme të lumit Shkumbin në lartësinë 120 m. Është rreth fushor dhe pjesërisht kodrinor-malor. Lartësia mesatare është 440 m. Maja më e lartë është mali i Jeronishtit (1883 m). Malet ndodhen në Veri-Lindje, Lindje dhe Jug-Lindje (si Labinot dhe Shpati). Kodrat ndodhen në Veri-Perëndim, Perëndim dhe Jug-Perëndim si kodrat e Dumresë, Sulovës dhe Llixhës. Fushat ndodhen në pjesën qendrore si fusha e Elbasanit, Cërrikut, Gostimës.

### **BASHKIA ELBASAN**

Elbasani përfshin :Bradashesh, Funar,Gjergjan, Gjinar, Gracen, Labinot-Fushë, Papër, Shirgjan, Shushicë, Tregan, Zavalinë dhe qendra e qytetit është e ndarë në 6 Rajone.

**Historiku i Qytetit të Elbasanit.** Historia e trevave të Elbasanit e ka zanafillën e saj në shekullin e II-të p.k. me vendbanimet e hershme ilire. Në shekullin e II-të qyteti njihet me emrin “SKAMPA” e më vonë me emrin “SKAMPINI” në varësi administrative të Durrahut. Duke qënë i vendosur në kryqëzimin e rrugëve Veri – Jug dhe Lindje – Perëndim, ai ka shërbyer si pikë e rëndësishme kalimi dhe si stacion i rëndësishëm, duke u përmendur si qendër urbane, ushtarake e peshkopale. Pas bllokimit të rrugës Egnatia nga dyndjet e barbarëve, qyteti nuk përmendet më dhe njihet shkatërrimin e tij gjatë migrimit sllavo – bullgar diku nga shekulli VI - VII.

Foto Nr.12-13. Pamje nga qyteti i Elbasanit



**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**



Elbasani u zhvillua si qendër e rëndësishme strategjike, administrative, ushtarake dhe ekonomike e Shqipërisë së mesme. Zejtaria dhe tregtia mori përsëri një zhvillim të dukshëm duke shtrirë lidhjet dhe ndikimin në tërë zonat përreth. Një zhvillim të ndjeshëm mori arti postbizantin i përfqësuar nga mjeshtri dhe piktori i madh Onufri i Neokastrës (Elbasanit), i cili krijoi një art kulminant ku spikat me forcë të veçantë gërshetimi i shkëlqyer i gjenit me traditën vendase. Si vepra të tij, të trashëguara deri në ditët tona, janë afresket dhe ikonat e kishave të Shelcanit dhe të Valshit të mesit të shek. XVI. Vazhdues i veprës së Onufrit përmendet Kostandin Shpataraku. Një zhvillim të vrullshëm mori qyteti i Elbasanit në shek. XVII me krijimin, organizimin dhe funksionimin e 60 llojeve të zejeve në 45 Esnafe.

**Trashëgimia Kulturore.** Në krahun e djathtë të derdhjes së lumit Shkumbin atje ku ai kryqëzohet me rrugën e famshme Egnatia shtrihet qyteti i Elbasanit me emrin e lashtë Skampis. Gjatë historisë së lashtë Elbasani e ndërroi shpesh emrin e tij, por për herë të parë e gjejmë të shkruar në dokumentat historike të shekullit të II-të si vicus me emrin Scampis në varësi të Dyrrahut. Scampisi ishte një kastium (kështjellë) tipike romake e ndërtuar në kapërcjellin e shek.III- IV e.s. Fortesa rrethohej me mure të fuqishëm. Nga të katër anët një hendek i thellë me ujë dhe 26 kulla të formave të ndryshme (në formë U-je dhe patkoi) përforconin fuqinë mbrojtëse të saj. Kalaja kishte katër hyrje një për secilën anë. Në shek. VI qyteti zhvillohet jashtë kështjellës duke qenë qendër peshkopale me një katedrale dhe një bazilikë në kodrën e Tepes pranë Kalasë. Në vitin 1466 Kalaja e Elbasanit bie në duart e osmanëve, të cilët e rindërtuan thuajse tërësisht dhe prej tyre ai mori emrin Ilj-basan (Elbasan). Në mes të shek.XVII-të ai numëronte 900 dyqane, 2.000 shtëpi banimi. Zejet më të dëgjura ishin regjia e lëkurave (tabakët), punimi i mëndafshit dhe i argjëndit (zbukurime dhe armë). Brenda qytetit përveç banesave dhe dyqaneve Elbasani përmbante tashmë një numër të madh ndërtesash kulturi si: kisha, manastire, xhami, dhe hamame (banja publike).

### **1. Kështjella e Skampis-it.**

Kështjella e Scampis-it është ndërtuar në kohën e sundimit të perandorit Dioklecian (284-305). Ajo është ndërtuar tërësisht sipas teknikës romake opus mixtum. Muri i kësaj periudhe ndërtimi me trashësi 3 m gjendet kudo në nivelin e poshtëm të kështjellës.

**2. Via Egnatia.** Kjo rrugë është vazhdimi i Via Appia-s që fillon nga Roma antike deri në Brindisi. Në vendin tonë Via Egnatia fillon nga Apollonia dhe Dyrrahu, dy degëzime që bashkohen pranë Scampis-it në bregun e majtë të përroit të Zaranikës për të vazhduar drejt Lindjes në veri të liqenit të Ohrit deri në Selanik. Kjo rrugë mendohet se është ndërtuar midis viteve 146-120 p.e.s.

**3. Xhamia Mbretërore.** Xhamia Mbretërore është një nga faltoret më të hershme të Shqipërisë, daton në vitin 1492. Kjo faltore përputhet me të gjitha xhamitë e tjera të emëtuara mbretërore që u



**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**

ndërtuan nga Sulltan Bajaziti i II-të në fund të shekullit të XV. Xhamia u mbyll në 1967 gjatë diktaturës komuniste dhe u rihap mbas 1990.

**4. Kisha e Shën Mërisë Elbasan.** Kisha e Shën Mërisë ndodhet brenda kështjellës së Elbasanit dhe është rindërtuar në vitin 1833.

Foto Nr. 15. Pamje e Kishës së Shën Mërisë



**5. Hamami i Kalasë.** Hamami brenda Kalasë, njihet edhe si Hamami i grave, i takon fundit të shekullit të XVI. Skema e hamamit fillimisht përbëhet nga tre dhoma kryesore: dhoma e zhveshjes, e izolimit dhe e larjes. Gjatë shekullit XX, Hamami i Kalasë u përdor si magazinë ushqimore. Sot, në këtë ndërtesë ka një lokal.

**6. Kulla e Sahatit.** Kulla e parë e Sahatit u ngrit këtu në shekullin e XVII dhe u rrënuar para vitit 1854. Kulla e dytë prej druri, e ngritur gjatë viteve 1865-1869. Pas rrëzimit kjo kullë u zëvendësua me kullën vazhduese në 1899.

Foto Nr.16. Pamje nga Kulla e Sahatit të qytetit të Elbasanit



Burimi informacionit: Faqja online: [elbasani.gov.al](http://elbasani.gov.al) Drejtoria e kulturës në Bashkinë Elbasan

**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**

**Popullsia dhe aktivitetet kryesore ekonomike të zonës.** Elbasani është një qark tjetër që ka shënuar rënie të konsiderueshme të popullsisë banuese. Në vitin 2015, popullsia e këtij qarku ishte 293 mijë banorë me rënie 18 për qind nga 362 mijë banorë në vitin 2001. Rënia mesatare vjetore ka qenë 1.8 për qind. Popullata urbane më 2013 qe 112 mijë banorë me rënie 9.2 për qind nga 124 mijë banorë që qe më 2001. Norma e urbanizimit në Elbasan është rritur nga 34 në 38 për qind. Elbasani ka 3199 kilometra katrore dhe 92 banorë për kilometër katror.

**Ajri, uji, faktorët klimatikë, zhurmat etj.**

**Temperatura.** Qyteti i Elbasanit, sipas ndarjes klimatike të Shqipërisë, bën pjesë në zonën mesdhetare kodrinore dhe nën-zonën mesdhetare kodrinore qendrore. Larmia e formave të relievit dhe shtrirja e gjerë veri-jug e kësaj nën-zone ndikojnë në regjimin e elementeve klimatikë. Temperatura mesatare e ajrit është ajo e qytetit të Elbasanit, dhe varion nga 6.7°C në Janar deri në 23.4°C në Korrik. Temperatura mesatare maksimale varion nga 11°C në janar deri në 31.2°C në korrik. Temperatura mesatare minimale varion nga 2.2°C në janar deri në 15.8°C në Korrik. Temperatura minimale absolute është regjistruar në Janar të vitit 1968 me -7.5°C dhe ajo maksimale absolute është regjistruar në Korrik 1988 me 42°C.

**Rrezatimi diellor.** Regjimi i rrezatimit karakterizohet nga një sasi vjetore e rrezatimit diellor prej 1448.5 këh/m<sup>2</sup>, ku vlera më e ulët haset në dhjetor me 50.1 këh/m<sup>2</sup> dhe vlera më e lartë në korrik me 202.1 këh/m<sup>2</sup>. Gjatë vitit hasen mesatarisht 2442 orë me diell. Muaji me numrin më të lartë të orëve me diell është korriku (326 orë), ndërsa dhjetori ka vetëm 111 orë me diell, ç’ka është dhe vlera më e ulët gjatë vitit.

**Era** është një element i rëndësishëm klimatik për të cilin mund të thuhet se zona e Elbasanit karakterizohet nga vlera të larta të qetësisë (rreth 53%) dhe shpejtësi mesatare minimale 1.2m/s gjatë verës e shpejtësi mesatare maksimale 2.1 – 2.4 m/s në dimër. Erërat që fryjnë nga verilindja janë dominuese gjatë gjithë vitit dhe vlerën maksimale e arrijnë në dimër me 4.7 m/s. Në pranverë shfaqet drejtimi dominues, jugperëndimi me rastisje 11.9%. Ndikimi i jugperëndimit vazhdon të jetë i fortë gjatë verës, ndërsa gjatë vjeshtës forcohet përsëri veprimi i erërave verilindore. Drejtimi veriperëndimor arrin vlera të larta shpejtësie në vjeshtë, por ndikimi i tij është i papërfillshëm për shkak të rastisjes së ulët prej 1.3%.

**Reshjet.** Përsa i përket reshjeve, pjesa më e madhe e tyre bien në gjysmën e dytë të vitit dhe më pak në gjysmën e ngrohtë, për shkak të aktivitetit ciklonik. Gjatë gjysmës së ftohtë bie 65.8% e shumës vjetore të reshjeve dhe gjatë gjysmës së ftohtë bie 34.2%. Shuma vjetore e reshjeve është 1148 mm, ndërsa maksimumi 24 orë i reshjeve është 134.9 mm. Reshjet në formë bore janë dukuri e rrallë për zonën e Elbasanit ku bën pjesë edhe territori dhe objekti për aktivitetin “Linjë Përpunimi dhe Prodhimi i Çajit të Ftohtë nga Bimët Medicinale”, Bashkia Elbasan. Numri i ditëve me shtresë bore është i ulët dhe ka një vlerë mesatare prej 1.2 ditë në vit.

**Infrastruktura rrugore.** Objekti i ka të gatëshme infrastrukturat rrugore duke komunikuar direkt me rrugën e qytetit të Elbasanit dhe autostradën Elbasan-Metalurgji.

**Zhurmat.** Duke qenë se është zonë me funksion industrial dhe shërbimi, zhurmat janë të pranishme dhe të ndjeshme gjatë fazës së ndërtimit dhe shfrytëzimit të objektit. Gjatë fazës së ndërtimit, zhurmat nga automjetet janë një ndikim që duhet të merren në konsideratë, ato janë të vazhdueshme edhe pse minimale. Në zonën në studim ka monitorime të realizuara në zona të ndryshme të kryqëzimeve në Elbasan.

**Shkarkimet si pasojë e transportit.** Nga vitet 1990 deri më sot janë shtuar shumë lëvizjet nëpërmjet transportit sidomos atij privat. Mbizotërues është transporti rrugor që sipas statistikave pritet të rritet deri në fund të vitit 2019. Shkarkimet si pasojë e transportit lidhen me disa probleme që kanë të bëjnë me cilësinë e karburantit që përdoret në motorrat e automjeteve, numrin gjithmonë në rritje të automjeteve, moshën dhe fuqinë motorrike të tyre, mirëmbajtjen e tyre. Në zonën ku kryhet aktiviteti ekonomik, numri i automjeteve është i madh për arësye të vendosjes së objektit në

**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**

vijën e parë të ndërtimeve në një nga kuadratet e zonës ekonomike dhe pranë rrugës që të çon në fabrikën e Çimentos Elbasan.

**Cilësia e ajrit.** Ndotja e ajrit është një problem i madh për qytetin e Elbasanit. Pranë territorit të këtij qyteti ndodhen prodhuesit më të mëdhenj në vend të industrisë së rëndë dhe asaj ndërtimore, ish Kombinati Metalurgjik, Fabrika e Prodhimit të Ferrokromit, Fabrika e Masës Karbonike si dhe një sërë objektivash të tjera industriale.

Foto Nr. 17. Pamje nga ish Kombinati Metalurgjik Elbasan



**Cilësia e ajrit për Elbasanin dhe zonën përreth**

Tabela Nr. 02. Normat e BE për ajrin urban

Normat e BE	PM10 µg/m <sup>3</sup>	PM2.5 µg/m <sup>3</sup>	SO2 µg/m <sup>3</sup>	O3 µg/m <sup>3</sup>	CO mg/m <sup>3</sup>	NO2 µg/m <sup>3</sup>	Benzeni µg/m <sup>3</sup>
1 orëshe			350			200	
8 orëshe				120	10		
24 orëshe	50		125				
Vjetor	40	25				40	5


**Të dhënat e PM10 .**

Referuar të dhënave mujore të monitoruara, vlerat më të larta janë monitoruar në periudhën Janar-Shkurt dhe Nëntor –Dhjetor. Vlera më e lartë në këtë stacion është regjistruar në dhjetor dhe kjo vlerë është 109.63 µg/m<sup>3</sup>. Kemi tejkalim në muajt Janar dhe Shkurt ku vlerat e monitoruara janë 74.24 µg/m<sup>3</sup>.dhe 46.04 µg/m<sup>3</sup>. si dhe nëntor, ku vlera e monitoruar është 66.55 µg/m<sup>3</sup>. Referuar muajve të tjerë të vitit theksojmë se vlerat e monitoruara janë nën normë, gjë që ka ndikuar dhe në vlerën mesatare vjetore, e cila është nën normën e BE. Në stacionin e Elbasanit në periudhën janar-Shkurt dhe dhjetor, ku vlerat e monitoruara janë 84.52 µg/m<sup>3</sup>. , 55.08 µg/m<sup>3</sup>. dhe 49.18 µg/m<sup>3</sup>.

Grafiku Nr.01. Mesataret vjetore te PM10




**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**



Në stacionin e Elbasanit vlerat vjetore të monitoruara përafrohen me normën e BE, po pa e tejkaluar. Këto vlera janë  $38.67 \mu\text{g}/\text{m}^3$  në stacionin e Elbasanit. Analiza e të dhënave të paraqitura në grafikët e mëposhtëm tregon disa aspekte të rëndësishme të cilësisë së ajrit në Shqipëri. Gjendja e cilësisë së ajrit të qyteteve kryesore të Shqipërisë nuk është sigurisht optimal dhe paraqet një situatë jo të mirë sidomos për  $\text{PM}_{10}$  në të gjitha qytetet. Kjo është pasojë e urbanizimit të lartë dhe ndotja vjen nga rritja e numrit të makinave që qarkullojnë në rrugë si dhe veprimtarisë industriale, sidomos në Elbasan.

Grafiku Nr. 02. Numri i ditëve që tejkalojnë normën e ditëve të lejuara për  $\text{PM}_{10}$




Një nga treguesit kryesorë të cilësisë së ajrit urban për  $\text{PM}_{10}$  është dhe numri i ditëve që tejkalon normën ditore të BE prej  $50 \mu\text{g}/\text{m}^3$  nga numri i ditëve të lejuara në një vit që është 35 ditë. Kemi përaftrim të numrit të ditëve të lejuara në vit për stacionin e Durrësit dhe Elbasanit, ndërsa në stacionin e Shkodrës, Vlorës dhe Tirana ATSH, numri i ditëve që tejkalojnë normën ditore të BE është i ulët.

Tabela Nr. 03. Numri i ditëve që tejkalojnë normën ditore të  $\text{PM}_{10}$  prej  $50 \mu\text{g}/\text{m}^3$

Viti 2016 PM10	Numri i ditëve që tejkalojnë normën ditore të BE ( $50\mu\text{g}/\text{m}^3$ )	Nr. ditëve të lejuar/vit
Durrës	34 ditë /341 ditë monitorimi	35
Elbasan	34 ditë /230 ditë monitorimi	35


Grafiku Nr. 03. Mesataret vjetore të  $\text{NO}_2$  Të dhënat e  $\text{NO}_2$

**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**




Bazuar në të dhënat mesatare vjetore të monitoruara në stacionet e sipërpërmendura rezultojnë se, nuk kemi tejkalim të vlerës limite vjetore të BE në asnjë nga stacionet e monitoruara. Vlerat më të larta vjetore janë monitoruar në stacionin e Tirana ATSH, ku vlera e monitoruar është 30.18 µg/m<sup>3</sup>, në Elbasan me 26.41 µg/m<sup>3</sup> dhe Durrës. 24.49 µg/m<sup>3</sup>. Kjo është e pritshme sepse të tre stacionet janë stacione të instaluar pranë rrugëve kryesore dhe me burim ndotje trafikun.

Grafiku Nr. 04. Të dhënat e SO<sub>2</sub>




Grafiku Nr.05. Vlerat vjetore të O<sub>3</sub>. Të dhënat e O<sub>3</sub>




Monitorimi i O<sub>3</sub> është realizuar në 6 stacione si Durrës, Elbasan, Korçë, Tirana ATSH, Shkodër, dhe Vlorë. Nivelet e larta të Ozonit në stacionet urbane background ndodhin për shkak të temperaturave të larta dhe të niveleve të larta të rrezatimit diellor. Përsa i përket vlerave 8 orare të ozonit kemi tejkalim të normës 8 orare prej 120 µg/m<sup>3</sup> në dy stacionet e sipërpërmendura.

**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**

Grafiku Nr. 06 Mesataret vjetore të CO



Grafiku Nr. 07 Mesataret vjetore të Benzenit



Monitorimi i Benzenit është realizur në 6 stacione. Vlera mesatare vjetore më e lartë është monitoruar në stacionin e Korçës dhe është  $4.19 \mu\text{g}/\text{m}^3$  nga  $5 \mu\text{g}/\text{m}^3$ , që është norma vjetore e BE, pra kemi përafërim të normes vjetore por pa e tejkaluar atë.

**Matjet për vitin 2016 sipas IFBZ.**

Stacioni i vendosur në qendër të Elbasanit është stacioni që administrohet nga AKM dhe mostrat e fraksionit PM10 janë duke u mbledhur nga specialistët e kësaj Agjencie me një sistem automatik të tipit Tekora. Mostrat 24 orësh mbledhen me frekuencë ditore. Numri i mostrave të mbledhura dhe të analizuar janë në përputhje me ato të parashikuara në projekt.

Tabela 04. Përmbledhje e mostrave të mbledhura

Muaji	IFBZ			Elbasan	
	PM10		Bloza	PM10	
		Plan			Plan
Janar	9		9		
Shkurt	10		10	8	
Mars	11	10	11	28	10
Prill	10	10	10	17	10
Maj	7	10	7	18	10
Qershor	9	10	9	18	10
Korrik	9	10	9	29	10
Gusht	10	10	10	16	10



**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**

Shtator	9	10	9	18	10
Tetor	10	10	10	22	10
Nentor	10	10	9	22	10
Dhjetor	9	10	9		10
Total	113	100	112	196	100

**Stacioni Qendër, Elbasan**

Baza e të dhënave për stacionin e qendrës së Elbasanit përmban faqen me përqendrimet e elementeve (PM10, S, Cl, K, Ca, Ti, Cr, Mn, Fe, Ni, Cu, Zn, Br, Sr, Pb) si dhe faqen me gabimet përkatëse për secilin element. Matje të blözës nuk ka. Faktorët (burimet) e identifikuar mund t'i ndajmë në dy grupe kryesore, burimet me origjinë natyrale dhe ata me natyrë antropogjene. Në grupin e burimeve natyrale bëjnë pjesë “Pluhuri mineral” dhe “Kripa e detit”, kontributi mesatar vjetor i të cilëve në masën e fraksionit PM10 arrin në rreth 38% ndonëse në ditë të caktuara ata mund të bëhen dominues. “Pluhuri mineral” duhet të përfshijë si pluhurin e dheut ashtu dhe kontributin e pluhurit të shkretëtirës së Saharasë. Në disa nga ditët me vlerë të lartë të PM10 kemi vënë re se masat ajrore kanë origjinë nga veriu i Afrikës. Edhe në Elbasan është prezent burimi që vjen nga djegia e biomasës, që mesatarisht kontribuon rreth 7% të masës së PM10 dhe është më i lartë në periudhën e dimrit gjatë të cilit djegia e druve përdoret për ngrohje. Në fakt dy burimet që mund të lidhen me trafikun si burimet “Pluhur i rrugës” dhe “Trafiku” bashkërisht kanë një kontribut mesatar që arrin në rreth 37%.

Tabela 05. Përmbledhje e rezultateve mbi faktorët kryesore të ndotjes në aerosolin në Elbasan

	Emërtimi i faktorit		Profili i faktorit	Kontributi mesatar vjetor në masën e PM10 (%)
1	Kripe deti	Masa ajrore detare	Cl	3.8
2	Pluhur mineral	Pluhur dheu ku përfshihen edhe episodet e ndikimit të masave ajrore nga Sahara	Ti, Mn, Fe, Ca, K, Sr	34.4
3	Ind/Metalurgji	Shkarkime nga industria metalurgjike	Zn, Pb	0.2
4	Djegje biomase	Djegje drush	K, Mn, Br, S	7.1
5	Industri	Shkarkime nga industria ferrokrom	Cr, Mn, Pb	4.5
6	Pluhur rruge i risuspenduar	Pluhur rruge i ndotur nga trafiku dhe Industria e ndërtimit /fabrikat e çimentos	Ca, Br	17.9
7	Trafik/Djegje mazut	Shkarkimet e trafikut/ djegje e mazutit	Fe, Cr, Mn, Ni, Cu, Ca, Sr	19.1
8	Sulfate sekondare	Aerosol sekondar (transformimi i oksideve të S në sulfate)	S	13.0

Tabela Nr. 06

Stacioni	Vlera mesatare vjetore (µg/m3)	Tejkalimi i limitit
IFBZ – PM10	27.6	8 % (9/113 ditë)
Elbasan, qendër – PM10	31.7	7.8 % (14/196 ditë)

**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**

Situata e ndotjes me metale toksike në stacionet e monitoruara nuk është problematike, duke qenë se përqendrimet e të gjithë metaleve janë mjaft më të ulët se normat e lejuara. Në stacionin e Elbasanit vihet re tendencë zbritëse e Pb. dhe disa metaleve.


### **Cilësia e ujit për Elbasanin dhe zonën përreth**

Problemi i ndotjeve të ujrave aktualisht është pothuajse i pashmangshëm dhe kjo si pasojë e të gjitha veprimtarive urbane, industriale dhe bujqësore që zhvillohen në këtë zonë.

Ujrat që do të përdoren për ndërtimin e objektit “Ngritje e Katit të Dytë Njësi Shërbimi mbi Objektiv Ekzistues 1 Kat + Podrum” janë ujra industriale, ose ujë i pishëm. Këto ujra janë të lidhur me rrjetin kryesor të infrastrukturës së objektit dhe zonës. Pranë zonës ku ndërtohet, kalojnë ujrat e Përroit të Manazderes dhe Lumit të Shkumbinit. Gjendja e këtyre ujrave paraqitet si vijon:

**Baseni i Shkumbinit.** Rrjeti i monitorimit përbëhet nga katër stacione, Qukës, Topçias, Papër dhe Rrogozhinë, në të cilat vlerësohet gjendja e ujrave të këtij lumi në rrjedhën e sipërme, në rrjedhën e mesme dhe në rrjedhën e poshtme, para derdhjes së lumit në det.

Grafiku Nr. 08




Baseni i Shkumbinit i cili monitorohet në 4 stacione, për vitin 2016, paraqitet brenda normës së lejuar, ku në dy stacionet e para Qukës dhe Topçias, ujërat klasifikohen në gjendje të lartë – të mirë, me një rritje të lehtë në Papër e Rrogozhinë ku vlerat e këtij parametri janë 5 mg O/litër (norma < 7 mg/l) duke i klasifikuar ne Klasen III – gjendje e moderuar.

### ✓ **Përmbajtja e amoniakut**

Përcaktimi i përmbajtjes së amoniakut në kampione uji i përcaktuar me metodën spektrometrike është parameter kryesor i klasifikimit në klasa të cilësisë së ujërave sipas DKU. Baseni i Shkumbinit vlerësohet me një përmbajtje të sasisë së amoniakut nga 0.14 mg/l në 0.16 mg/l, duke i cilësuar këto ujra me cilësi të mirë – Klasa II ku vlera më e lartë paraqitet në Topçias, si rezultat i shkarkimit të kolektorëve të ujrave urbane të qytetit të Elbasanit. Në Sh 1 – Qukës ujrat vlerësohen në Klasën I – gjendje e lartë.

Grafiku Nr. 09




**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**

✓ **Përmbajtja e nitriteve**

Baseni i Shkumbinit gjithashtu klasifikohet në gjendje të mirë – Klasa II me vlera që variojnë nga 0.012 mg/l – 0.016 mg/l.


Grafiku Nr.10



✓ **Përmbajtja e nitrateve**

Përmbajtja e nitrateve në të gjitha stacionet e monitoruara rezulton në vlera më të ulëta se norma e lejuar (< 0.8 mg/l). Referuar këtij treguesi të gjithë basenet janë të një cilësie shumë të mirë.


Grafiku Nr. 11



✓ **Përmbajtja e fosforit**

Baseni i Shkumbinit në stacionin e referencës, Sh1 – Qukës janë ujëra me cilësi të mire, ndërsa në tre stacionet e tjera, vlerat e përmbajtjes së fosforit variojnë nga 0.098 mg/l – 0.148 mg/l, ujëra me cilësi në gjendje te moderuar.

Grafiku Nr.12





**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**

Përmbajtja e fosforit total në basenin e Shkumbinit në të katërt stacionet e monitorimit përmbajtja mesatare e fosforit total varion nga 0.125 mg/l – 0.162 mg/l, duke i renditur këto ujëra në Klasën II – gjendje e mirë.

Grafiku Nr.13




Tabela Nr. 07. Klasifikimi i cilësisë së baseneve për vitin 2016.

Cilesia	Baseni Drini - Bune	Baseni Ishem - Erzen	Baseni i Shkumbinit	Baseni i Semanit	Baseni i Vjoses	Baseni i Matit
Klasa I – Gjendje e lartë						
Klasa II – Gjendje e mirë					II	
Klasa III – Gjendje e moderuar			III			III
Klasa IV – Gjendje e varfër	IV					
Klasa V – Gjendje e keqe		V		V		

**Baseni i Shkumbinit** është një basen me cilësi, gjendje e moderuar, ku impakt të madh ndotjeje kanë stacionet e Paprit e Rrogozhinës të cilat e klasifikojnë këtë basen në klasën III.

**Ndotja e Tokës.** Studimi fushor për marrjen e mostrave të tokës u realizua me 12.07.2014. Për analizimin e nivelit të ndotjes nga metalet e rënda në këtë zonë janë përcaktuar 8 pika monitorimi në drejtimin verior, lindor dhe jugperëndimor të objektit industrial. Pika e parë është marrë rreth 70m nga objekti ndërsa e fundit ka një distancë prej rreth 2500 m. Tokat e kësaj zone paraqiten dobësisht dhe mesatarisht alkaline (7.9 deri në 8.3). Nga vlerësimi i përmbajtjes së humusit ato paraqiten mesatare në të gjitha pikat e monitorimit. Përsa i përket teksturës së tokës ajo paraqitet e ndryshme. Në pikat 1, 3 dhe 8 tokat janë të ekuilibruara lymore (ZL), në pikat 2, 4 janë të ekuilibruara (L), në pikat 5, 6 janë të ekuilibruara lymore argjilore (CL), ndërsa pika 7 është argjilore (C). Në lidhje me përmbajtjen e nikelit, kromit dhe plumbit nuk ka ndonjë rregullsi me rritjen e largësisë nga objekti. Të dhënat e analizuar treguan se përqëndrimet e zinkut, manganit dhe kadmiumit janë poshtë vlerave të përcaktuara kritike nga BE. Të gjitha tokat ku u morën mostrat janë të mbjella me kultura bujqësore. Ato janë të kultivuara kryesisht me jonxhë, grurë, misër dhe pemë frutore.

**Peisazhi.** Bashkia Elbasan, karakterizohet nga struktura specifike gjeografike, ku përfshihet mjedisi fizik, përbërja biologjike dhe strukturat njerëzore e sociale. Ajo rrethohet në pjesën veriore dhe veriperëndimore me masivin e ullishtës dhe Kodrën e Krrabës të pyllëzuar, në lindje me banesa të qendrës së qytetit të Elbasanit, në jug me lumin e Shkumbinit të cilat harmonizohen midis tyre. Në të gjitha këto pamje, ekosistemet natyrore, pylli, lumi, kodrat me ullinj, fushat, grupohen dhe kombinohen me peisazhin kulturor, krijuar nga veprimtaria njerëzore. Në tërësinë e tij, peisazhi

**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**

natyror i zonës ku realizohet aktiviteti ndërtimor i lë veprim të lirë peisazheve urbane dhe industriale, të përdorura intesivisht në zonën që zhvillohet si dhe gjelbërimit publik dhe atij privat.

Foto Nr. 18 – 19. Pamje nga Parku Rinia dhe Qendra e Elbasanit



**Gjeologjia dhe Gjeomorfologjia.** Pjesa e territorit ku do të realizohet aktiviteti industrial “Linjë Përpunimi dhe Prodhimi i Çajit të Ftohtë nga Bimët Medicinale”, Bashkia Elbasan është i përbërë nga formacione molosike. Nga pikëpamja strukturore e morfologjike, Elbasani është vendosur në taracë lumore, shkallët e së cilës janë formuar nga depozitimet poluviale të lumit Shkumbin gjatë periudhës kuaternare (Q4 pl), si pasojë e krijimit të shtratit të tij. Kjo taracë është e ndërtuar nga depozitime të përbëra nga formacione argjilore, konglomeratike aleorolitore me ranorë të rrallë. Në prerjen tërthore të depozitave vërehen alternime të këtyre depozitimeve. Ekzistenca e një litologjie të tillë, dëshmon se kemi të bëjmë me formacione gjeologjike me qëndrueshmëri mekanike të vogël. Nga pikëpamja gjeologjike ajo zë vend në qoshen jug-perëndimore të zonës së shkëputjeve normale tërthore Elbasan-Dibër, e cila përbëhet nga shkëputje fragmentare me shtrirje VL përreth 60 km brenda territorit tonë. Ajo ndiqet edhe përtej territorit tonë në Tetovë e deri në Gjilan, Kosovë. Kjo zonë shkëputjesh tërthore shtrihet rreth 200 km dhe nis me grabenin Kuaternar të Elbasanit, ndiqet me horstin e Gollobordës, me grabenin e Tetovës dhe përfundon me grabenin Kuaternar të Moravës së Bincës në Kosovë. Pikërisht kjo zonë shkëputjesh tërthore është shkaktare e tërmeteve të fortë që janë rregjistruar gjatë saj. Zona ku ndërtohet objekti, bazuar në klasifikimin kombëtar pedologjik sipas zonalitetit vertikal, vlerësohet në tipin e tokave të hirta kafe me sizmicitet 8 ballë. Këto toka janë zhvilluar kryesisht në zonën perëndimore të vendit në lartësi 0-200 m nga niveli i detit dhe shpesh shtrihen deri në lartësi 600 m mbi nivelin e detit. Depozitimet në zonën ku ngrihet objekti janë:

Depozitimet e Cretakut të Sipërm Cr2; Depozitimet e Paleogenit të Sipërm Pg1; Depozitimet e Tortornianit të Poshtëm (në tre shtresa); Depozitimet e Proluviale të kuaternarit; Depozitimet deluviale të Kuaternarit Q4 dl; Depozitimet aluviale të kuaternarit Q4 al.

#### **Administrimi i mbetjeve dhe ujërave të ndotura urbane**


Në zbatim të VKM Nr. 333 dt. 26.1.2011 “Për administrimin e vend depozitimeve rajonale të mbetjeve urbane”, është e domosdoshme hartimi i studimeve, projekt zbatimeve, si dhe ndërtimit të vend depozitimeve të reja rajonale. Sipas burimeve zyrtare, aktualisht për Prefekturën e Elbasanit, është ndërtuar sistemi i menaxhimit të mbetjeve urbane, duke përdorur mënyrën e djegies së mbetjeve me icenerator. Për shkak të gjendjes së rënduar të shesh-depozitimit aktual, pushteti qendror në bashkëpunim me atë lokal, gjetën këtë zgjidhje për përmirësimin e situatës dhe mbylljen e shesh-depozitimit aktual. Ky icenerator ka kapacitet të lartë përpunimi, saqë mund të menaxhojë ose asgjësojë mbetjet urbane jo vetëm për prefekturën e Elbasanit, por dhe më gjerë.

**Largësia** në distancë ajrore e objektit nga ligatinat dhe qendra të banuara është si më poshtë:

**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**

Qendra e qytetit të Elbasanit 2.51 km, nga Lumi i Shkumbinit 2.76 km, nga përroi i Zaranikës 928.98 m. dhe përroi i Kushës 2.15 km. Objekti ndodhet 809.59 m larg Fabrikës së Çimentos Elbasan dhe 186.57 m larg nga kodrat e ullishtës së fshatit Kusarth. Distanca nga qendra e Njësisë Administrative Bradashesh është 2.15 km si dhe nga kufiri i ish Kombinatit Metalurgjik.

Foto Nr. 24. Pamje e distancave të objektit ekzistues që ngrihet një kat në foton ajrore



**ç. skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektin, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit;**

Objekti është ekzistuese dhe nuk ka nevojë për ndërhyrje ndërtimore. Ai është i ndërtuar me konstrukcion beton arme. Ai është i ndërtuar me **Trarë prej betoni të armuar, Soletat. me traveta, Muraturë tulle, shtresë pllaka gres**, dyer dhe dritare duralumini. Dera e jashtme është me grilë dhe në madhësinë për hyrje dalje të makinave të furnizimit me materiale.

Aktiviteti teknik është zgjedhur nga projektuesit e objektit në mënyrë të tillë që të ketë:

1. Si qëllimi kryesor përveç ideimit të një strukture e cila të shërbejë për kategorinë e shërbimit edhe aplikimin i një arkitekture të kohës dhe të përshtatshme për aktivitetin që do të realizohet.
2. Objekti të jetë i qëndrueshëm nga lëkundjet sizmike
3. Objekti e ka të ngritur sistemin e mbrojtjes ndaj zjarrit
4. Objekti ka lidhje me ujin e pijshëm në zonë dhe me rrjetin e kanalizimeve për shkarkimin e ujrave të zeza dhe ujrave të përdorura
5. Ana teknike dhe arkitektura të zgjidhë qëndrueshmërinë e zhvillimit urban në zonë në fushën e shërbimit të qytetit të Elbasanit.


Kondiconet urbanistike për katin përdhe ku do të realizohet aktiviteti "Linjë Përpunimi dhe Prodhimi i Çajit të Ftohtë nga Bimët Medicinale", janë si vijon:

- Sipërfaqja e sheshit të ndërtimit është.....246.2 m<sup>2</sup>
- Sipërfaqja e ndërtimit egzistuese në katin përdhe është.....246.2 m<sup>2</sup>

Foto Nr. 19. Planimetria Teknologjike për aktivitetin “Linjë Përpunimi dhe Prodhimi i Çajit të Ftohtë nga Bimët Medicinale”, Bradashesh, Elbasan



**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**



Ambjentet e brendëshme të objektit në funksion të procesit teknologjik dhe të shërbimeve janë të ndara si vijon:

1. Magazina e lëndës së parë me sip.=47.5 m<sup>2</sup>
2. Ambjenti i kaldajës dhe kompresorit me sip. = 25.9 m<sup>2</sup>
3. Ambjenti e vendosjes së fryrësit dhe nxehësit PET me sip. = 19.2 m<sup>2</sup>
4. Ambjenti i laboratorit me sip. 6.22 m<sup>2</sup>
5. Ambjenti ku vendosen depozitat, linja e mbushjes, mbylljes, pasterizimit dhe etiketimit me sipërfaqe totale = 80 m<sup>2</sup>
6. Magazina e produktit final me sip. = 20.72 m<sup>2</sup>
7. Ambjenti i zyrave me sip. = 9.15 m<sup>2</sup>
8. Abjenti i tualetit dhe zhveshjes me sip. = 14. m<sup>2</sup>
9. Ambjenti i ngrënies me sip. = 9 m<sup>2</sup>

**Përshkrim i përgjithshëm për aktivitetin “Linjë Përpunimi dhe Prodhimi i Çajit të Ftohtë nga Bimët Medicinale”**

Në bazë të dokumentave të sipërpërmendura dhe bazuar në kërkesat e investitorit është hartuar planimetria e vendosjes për realizimin e aktivitetit industrial ushqimor për “Linjë Përpunimi dhe Prodhimi i Çajit të Ftohtë nga Bimët Medicinale”.

Fabrika ka dy dyer. Njëra derë shërben edhe si dalje emergjence

Foto Nr. 20-21 . Pamje e hyrjeve në objekt



**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**

Magazina e lëndës së parë do të sistemohet me rafte për vendosjen e lëndës së parë.

Magazina e prodhimit do të sistemohet me rafte për vendosjen e pakove dhe kolive të llojeve të ndryshme të çajit që prodhohet brenda ditës dhe i cili largohet në magazinat e firmës po atë ditë ose të nesërmen. Tualeti dhe ambjenti i zhveshjes së punëtorëve ndodhet në pjesën mbas ambjentit të prodhimit me derë nga jashtë objektit të prodhimit dhe është i ndarë nga siperfaqja e magazinës. Tualti është i lidhur me pusetën e shkarkimit.

***Sistemi i mbrojtjes nga zjarri.***

Magazina dhe salla e linjës së prodhimit janë paisur me një hidrant kundër zjarrit dhe bombola me shkumë.

Foto Nr. 22-23. Mjete të MKZ



Në objekt do të instalohet një impiant për mbrojtjen nga zjarri i cili funksionon me ujin e siguruar nga një depozitë uji 3000 litra. Magazina është e paisur gjithashtu me fikse dore. Përpara objektit ka një shesh rreth 130 m<sup>2</sup> për ngarkimin dhe shkarkimin e mjeteve.

***Mbi zbatimin e regullave të sigurimit teknik***

Në ambjentet e objektit të prodhimit janë të afishuara reklamime për zbatimin e regullave të sigurimit teknik.

**d) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;**

I gjithë procesi i punimeve të aktivitetit industrial ushqimor “Linjë Përpunimi dhe Prodhimi i Çajit të Ftohtë nga Bimët Medicinale”, Njësia Administrative Bradashesh, Elbasan, kërkon kryerjen e disa proceseve që janë të paraqitura në vazhdim.

▪ **Procesi tekniko – teknologjike i prodhimit të Çajit të ftohtë**

**Përshkrimi i instalimeve dhe teknologjisë së projektit.**

Në hapësirën e territorit ku zhvillohet veprimtaria do të instalohet teknologjia që shërben për ushtrimin e veprimtarisë si dhe do të ndërtohet edhe infrastruktura e shërbimeve mbështetëse e operacioneve.

**A. Llojet e Çajrave që do të prodhohen nga Shoqëria "BIO FLORES" shpk. janë:**

- ✚ Çaji i malit (sideritis)

Foto Nr. 24-25. Pamje të çajit të malit



**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**



✚ Lavande ( lavandula)  
Foto Nr. 26-27. Pamje të lavandës



✚ Çaj lulesh (i prodhuar nga përzierja e disa luleve të çajit)

Foto Nr. 24-25. Pamje të kamomilit dhe lules së blirit



**B. Paisjet** e nevojshme për realizimin e projektit për prodhimin e çajit të ftohët janë:

1. Impiantet ( buffer tankat (copë 3 )
2. Pasteri ( copë 1)
3. Makina për fryrjen e ambalazhes PET
4. Makina për larje dhe mbushje
5. Makina për etiketimin e ambalazhes
6. Makina për paketimin në koli najloni

**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**

7. Kaldaja
8. Kompresori
9. Pompa, gypa etj.
10. 2 Depozita uji nga 3000 litra

**C. Lënda e parë për prodhimin e Çajit**

**1) Bimët medicinale**

- ✚ Çaji i malit (sideritis)
- ✚ Lavande ( lavandula)
- ✚ Çaj lulesh (i prodhuar nga përzierja e disa luleve të çajit)

Këto bimë do të vinë në repartin e prodhimit të pastruara dhe të paketuara nga fermeret e zones dhe nga kompani te cilat merren me tregtimin e bimeve medicinale.

- 2) **Uji.** Duhet të theksojmë se gjatë procesit teknologjik të prodhimit të çajit, uji do të përdoret si lëndë e parë. Uji është një lëndë e parë që konsiderohet më e rëndësishmja në shumë industri ushqimore. Kujdesi për ujë të duhur është shumë i madh, kërkon burime të konsiderueshme si dhe ekspertizë në mbushje në forma të ndryshme të paketimit. Uji që ka pastërti të njëjtë si në burim dhe nuk përmban asnjë ndotës sporogjen, përdoret për prodhimtari pas trajtimit nëpër filtra.

Uji është një lëndë e parë që konsiderohet më e rëndësishmja në shumë industri ushqimore. Kujdesi për ujë të duhur është shumë i madh, kërkon burime të konsiderueshme si dhe ekspertizë në mbushje në forma të ndryshme të paketimit. Uji që ka pastërti të njëjtë si në burim dhe nuk përmban asnjë ndotës sporogjen, përdoret për prodhimtari pas trajtimit nëpër filtra. Uji i burimit i cili përdoret për prodhim nuk duhet të përmbajë:

- Parazitë dhe format e tyre të zhvillimit të mikroorganizmave patogjen
- Llojet e bakteveve *Escherichia Coli* dhe bakteret e tjera Coliforme dhe Enterococe,
- Baktere specie *Pseudomonas Aeruginosa* (në 250 ml mostër),
- Bacilet sulfite-anaerobe sporogjene (në mostër 50 ml)
- Fortësia e ujit (□N): 10,5
- Përçueshmëria: 314 µS/cm, Ca<sup>2+</sup> 62 mg/L, Mg<sup>2+</sup> 6,3 mg/L
- Dyoksidi i klorit (mg/l): < 0,1

- 3) **Sheqeri (sakarozi)** - Sakarozi është një disaharid i njohur zakonisht si sheqer tavoline, kristale me ngjyrë të bardhë, pa erë, me një shije të ëmbël, është i njohur për rolin e tij në ushqimin e njeriut. Sakarozi përbëhet nga glukozja dhe fruktoza me formulë molekulare C<sub>12</sub>H<sub>22</sub>O<sub>11</sub>. Stevia (*S. rebaudiana* foliage) 4
- 4) **Stevia (*S. rebaudiana* foliage)** – e njohur si ëmbëlsues natyral e cila zëvendëson sheqerin e rëndomtë. Përdoret për pijet dietale për shkak se ka fuqi ëmbëlsuese qindra herë më shumë se sheqeri i rëndomtë, mirëpo nuk ka kalori.
- 5) **Acidi citrik** - Acidi citrik është një acid i dobët organik, i cili është një konzervans natyror dhe është përdorur edhe për të shtuar një shije acid për ushqime dhe lëngje të buta.
- 6) **Acidit askorbik** – vitamina C- Komponenti tjetër i cili përdoret në prodhimin e çajit të ftohtë është acidi askorbik, i cili përdoret duke përfutur tretësirën me koncentrim 15% të acidit askorbik. Acidi askorbik (C<sub>6</sub>H<sub>8</sub>O<sub>6</sub>), është një komponim me gjashtë atome karbon që gjendet në frutat citrike natyrale, në kaça. Acidi askorbik ka shije të këndshme të thartë çka i mundëson të përdoret në prodhim të pijeve të buta. Acidi askorbik (vitamina C) është një vitaminë vitale për njerëzit dhe është i njohur si antioksidant, produkt i oksidimit i të cilit është dehidroacidi askorbik.

**D. Lënda Ndhmëse për prodhimin e Çajit**

**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**

**Konservansët**

Për pregaditjen e shirupit të çajit të ftohtë i shtohen edhe konzervansët për shtuar jetëgjatësinë e konsumimit të çajit të ftohtë. Për të arritur këtë përgadisim tretësirën 5 % të konservansit (2,5 % Na-benzoat dhe 2,5 % K-sorbata).

**Benzoati Natriumit (Sodium benzoat)** -Përdoret si konzervans, i cili është bakteriostatik dhe fungistatik në kushte acidike. Zakonisht përdoret në ushqime me përmbajtje acidike sikurse janë lëngjet e gazuara, lëngje frutash (acide citrike), çajrat e ftohtë, sallatat me uthull, shtesave të ndryshme, turshitë etj.

**Sorbati i Kaliumit (Potassium sorbate)** - Përdoret në kombinim si konzervans, i cili është me përmbajtje kripë e kaliumit e përfituar nga acidi sorbik. Përdorimi primar është si konzervans duke përfshirë: lëngjet, ushqimin, verërat etj. përdoret për produkte bimore e cila parandalon mykun dhe zhvillimin e mikrobeve që mundëson zgjatjen e afatit të përdorimit, përdoret në atë sasi në të cilën nuk ka asnjë efekt anësor shëndetësor. Sorbati Kaliumit është konsideruar të jetë i sigurt për shkak të dhënave se në afate të gjata të përdorimit ka veti dhe profil jo-toksikë.

**E. Procesi i prodhimit**

Linja për prodhimin dhe mbushjen e çajit të ftohtë në shoqërinë "BIO FLORES" ka kapacitet prej 1200 – 1500 l/h. që mbushet në PET ambalazhe.

Hapat të cilët duhet të ndërmerren para fillimit të prodhimit të çajit të ftohtë janë:

1. Planifikim i produktit.

Në bazë të sasisë së kontejnerit të bazës së sirupit përcaktohet sasia e shtesave të cilat përdoren për prodhim.

2. Përcaktohet sasia e sheqerit të nevojshëm për prodhim.

3. Përcaktohet sasia e nevojshme e shtesave për sasinë e prodhimit.

4. Kontrollon sasia e cila do të prodhohet, dhe përcaktohet numri i tankeve të cilat do të përdoren për prodhim.

5. Bëhet lista e të gjithë sistemit të nevojshëm për prodhim, dhe i gjithë ky sistem (tanket, gypat) duhen të lahen me CIP (clean internal pipes/ pastrim në një qark të mbyllur) para prodhimit.

6. Përgadisim shurupin e sheqerit me sasi të BRIX 65 %, sasia në masë që do të thotë (65 kg shkon 35 Ujë). Sasia e shurupit të sheqerit mund të përdoret deri në tri ditë. Tanku i sheqerit duhet të mbahet nën vakum që të mos vijë deri tek ngurtësimi i sheqerit. Nëse dihet se nuk do të punohet më shumë se një ditë atëherë punohet shurupi sheqerit (sherbeti) vetëm për 24 orë.

7. Bëhet kontrolli e BRIX që përcakton sasinë e sheqerit në Ujë.

8. Pregaditen shtesat sipas recepturës dhe përcaktohet sasia e saktë e nevojshme për prodhim. Acideve citrik, askorbik dhe konzervansat (Sorbit Natrium, Kalium Benzoat) nuk duhet të përzihen në mikser në dhomën e sirupit. Fazat e prodhimit janë të paraqitur si më poshtë:

Procesi kalon nëpër këto faza:

**Faza e parë :** Përgatitja e bazës ( ekstraktit) të çajit

**Faza e dytë:** Përgatitja e tretësirës së sheqerit

**Faza e tretë:** Tretja dhe dozimi i acidit citrik + acidit askorbik (C-vitamina)

**Faza e katërt:** Dozimi i koncentratit

**Faza e pestë:** Tretja dhe dozimi i konzervansave (Kalium sorbat + Natrium benzoat)

**Përgatitje e ekstraktit të çajit**

Përgatitja e çajit fillon me pregaditjen e bazës së çajit ( ekstraktin) mvarësisht llojin e çajit që dëshirojmë të prodhohet në buffertank me volumin prej 1000 m<sup>3</sup>, i ndërtuar nga inoksi me mure të dyfishtë, mes të cilëve kalojnë gypat që përdoren për nxemje deri në temperaturë të larta, që

**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**

përdoret për zierjen e llojit të çajit që duhet të prodhohet d.m.th fitimin e bazës ( ekstraktit ) të çajit që duhet të prodhohet.

### **Përgatitja e shirupit**

Procesi i prodhimit të shirupit kalon në disa faza. Së pari përgatitim tretjen sheqerore dhe e dërgojmë në bufertank të shirupit të sheqerit, pastaj në dhomën e mikserit ku përgatiten më përbindjen adekuate aditivët si (acidi citrik & askorbik, komponentja bazë, ekstrakti, aromatizuesi dhe konzervansat). Tanket e shirupit në fillim të deponimit duhet të jenë të zbrazëta, dhe të mos jenë të lidhur me sistemin e CIP-it. Në fillim të prodhimit bëhet lidhja për deponimin i shtesave të shirupit në këto tanke, sipas recepturës së dhënë në panelin komandues. Këto komponente e përgatiten në dhomën për përgatitjen e shirupit. Me pas vendoset shurupi i sheqerit që kryesisht përbëhet nga sheqeri dhe uji. Gjatë prodhimit lidhen gypat për zbrazjen e tankeve dhe mund të përdoret vetëm njëri tank, gjersa pas zbrazjes lidhet tanku i dytë. Mund të përdoret vetëm një lloj i recetës gjatë një prodhimi, dozimi i shirupit aktivizohet në panelin e karbonizimit ku vendosen parametrat sipas recepturës. Kur çaji është i gatshëm për mbushje, para fazës së pasterizimit bëhet kontrolli laboratorik i ingredienteve dhe produktit të gatshëm, analizat kimike dhe mikrobiologjike i lëngut që duhet të mbushet:

### **Përgatitja e lëngut të gatshëm**

200 L shirup + 800 L ujë = 1000 L lëng të gatshëm ose.

230 Kg shirup + 800 Kg ujë = 1030 Kg lëng të gatshëm

Tabela Nr.08

Parametrat për lëng të gatshëm	Plastikë
Çaj i Ftohët	
Materia e thatë (xBrix)	7,9 ± 0,3
Titri (ml 0,5 N KOH/100 ml)	6,43 ± 0,3
Aciditeti total i shprehur sikurse tek acidi citrik anhidrid (g/L)	2,06 ± 0,1
Pesha specifike (g/ml)	1,03

Brixi i shirupit duhet të jetë 35.18 °Bx

Briksi i Çajit të ftohët duhet të jetë 7.9 °Bx

Titri i Çajit të ftohët duhet të jetë 6.43

Për ta ulur aciditetin (titrin) shtohet më pak Acid citrik

**Në dy( 2) impiante tjera me volumin nga 3000 m<sup>3</sup>** të ndërtuar nga inoksi që përdoret në industrinë ushqimore, bëhet përzierja e bazës së çajit me komponentët e tjerë dhe finalizimi i shijes së ajit që duhet të prodhohet.

Mostrat mikrobiologjike bëhen tek:

1. Koncentrati – gjatë dozimit
2. Përzierja e shirupit të sheqerit
3. Shirupi – i çdo sharzhe
4. Të lëngut të papasterizuar
5. Të lëngut të pasterizuar
6. Produktit përfundimtar

Para mbushjes:

1. Shishet e zbrazëta dhe shishet pas shpëlarjes
2. Mbyllëset (ambalazh në mbushësa)
3. Strisho e pajisjeve



**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**

**Udhëzime për pasterizim**


Në pasterizatorin rrjedhës duhet të jetë temperatura  $93, 2^{\circ}\text{C}$  dhe koha minimale e qëndrimit të çajit të ftohët në këtë temperaturë është 27- 30 sekonda, (njësi pasterizuese  $NjP= 45$ ). Lëngu i pasterizuar kalon menjëherë nëpër ftohës i cili ftohet në shkëmbyes të nxehtësisë me glykol (temperatura e produktit të ftohur sillet prej 2 deri  $4^{\circ}\text{C}$ ). Pasterizimi synon të reduktojë numrin e baktereve patogjene që të reduktohen gjasat e dëmtimit të produktit (duke supozuar se produkti i pasterizuar është ruajtur në kushte të caktuara si dhe për ta konsumuar para datës së skadimit).

**Pasterizimi** është procesi i ruajtjes së produkteve me anë të nxehtëtit, në të cilat ushqimet nxehen prej  $90^{\circ}\text{C}$  deri në  $95^{\circ}\text{C}$ . Qëllimi i pasterizimit është që të shkatërrojë format vegetative të baktereve, myshqeve, majave, për të parandaluar enzimën që të bëjnë ndryshime të padëshirueshme në ushqime, për të ruajtur vlerën ushqyese, si dhe për të ruajtur dhe përmirësuar vetitë organoleptike të ushqimeve. Shpejtësia e mbushjes është e varur nga diametri i gjilpërës për mbushje dhe lëvizja e lëngjeve në enë. Gjatë mbushjes së shishes, gjilpëra për mbushje nuk është në kontakt me lëngun, ndërsa ajri i cili del nga shishja kalon në ajër atmosferik, pra nuk kthehet në shishe. Kapaciteti i mbushjes është 5000-6000 shishe / orë, me vëllime të ndryshme të 0,5 L-1,5 L. Më pas shishja e mbushur kalon në pjesën ku vendosen tapat, të cilat më parë sterilizohen me dezinfektues dhe rreze ultraviolete dhe mbyllin shishen hermetikisht.

Prodhuesi është i detyruar të pasqyrojë edhe në etiketën e produktit ushqimor shtesën e përdorur. Pasi shishja del nga mbushësi, i vendoset etiketa, ku edhe i shënohet lista e shtesave të përdorura me përbërje në përqindje, data mbushjes dhe koha e skadimit për konsum. Me pas shishet e mbushura paketohen, paletizohen dhe dërgohen në treg.

**Faza mbushëse.** Makina për fryerjen, larjen dhe mbushjen e produktit përben një kompleks makinash që janë të lidhura në mënyrë të pandërprerë me kapacitet prej 1200 – 1500 l/h. Procesi fillon me fryerjen e epruvetave deri në fitimin e amballazhes PET me vullume të ndryshme ( 0.33, 0.5, 1 dhe 1.5 lit) Amballazha e përdorur i plotëson standartet për përdorim në industrinë ushqimore. Pasi bëhet fryerja e amballazhes, fillon procesi i larjes së amballazhes dhe mbushja e çajit të ftohët në vullume të ndryshme, shishe ose kuti.

Foto Nr.26



**Etiketimi.** Pastaj çaji i mbushur kalon te makina për etiketim, ku bëhet shënimi i të dhënave për produktin dhe kompaninë.


Në fazën finale (përfundimtare) në Tunel makinën që arrin temperatura të larta bëhet ambalzhimi në najllon folije nga disa copë të amballazhes me produkt, mvarësisht nga sasia e çajit të mbushur në PET amballazhe bëhet edhe mbeshjtjellja me najllon folije nga 3, 4, 6, 9 ose 12 copë çaje të ambalazhuar.

Dhe në fund bëhet paletizimi i çajit të ambalazhuar dhe magazinimi.




**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**

Foto Nr.27-28. Skema teknologjike e Procesit për Përpunimin dhe Prodhimin e Çajit nga Bimët Medicinale



Shema teknologjike e prodhimit te cajit te ftohet

**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**



**Përshkrimi i procesit të pastrimit të gypave me qark të mbyllur- CIP**

Pastrimi- Përbrenda- Sistemit (Clean-In-Place /CIP), i referohet procesit të pastrimit të pajisjeve të përpunimit, pa i çmontuar pjesët e veçanta prodhuese. Pastrimi në vend, dukshëm redukton kohën dhe koston (dhe përgjithësisht jo efektivitetin) dhe implikimet e pastrimit manual. Për të arritur këtë, nevojitet përzjerje me përqendrime të përshtatshme që do të cirkëlohet përmes pajisjeve të procesit. Industritë që mbështeten në CIP, janë ato që kërkojnë nivele të larta të higjienës, duke përfshirë atë të pijeve jo alkoolike (lëngjeve), të qumështit, ushqime të përpunuara pasticerive, farmaceutike, dhe kozmetike. Kur një linjë e prodhimit është e pastër, ajo është baza për fillimin e prodhimit në këtë linjë.

Kontrulli i ndotjes mikrobiologjike është një nga parametrat më të rëndësishëm në këtë detyrë. Procesi prodhimit të çajit të ftohtë fillon me larjen e të gjitha pajisjeve (gypave përbrenda) për prodhim. Kjo arrihet duke përdorur solucione me koncentrim të caktuar të Sodës kaustike (NaOH) dhe Acidit Nitrik (HNO<sub>3</sub>), dhe më pas bëhet dezinfektimi me përzjerje të peroksidit të hidrogjenit, dhe acidit peracetik H<sub>2</sub>O<sub>2</sub>-ACOOH-CH<sub>3</sub>COOH).

I gjithë ky proces zhvillohet në kondita të posaçme të koncentrimit të solucioneve, temperaturës dhe kohës. Ky koncentrim arrihet duke bërë dozimin i Bazës dhe Acidit, me anë të pajisjeve për dozim, që do të thotë, përfitohet një përzjerje qarkulluese me përqendrim të caktuar (2% d.m.th.≈100ms). Pas kryerjes së larjes me B&A gjithmonë duhet të shikohet në panel sasia e mbetjeve të materieve për pastrim pas shpëlarjes me ujë të filtruar, duke shikuar konduktivitetin (përshkueshmërin) e cila paraqitet dhe matet me Siemens. Sasia e mbetur e joneve duhet të jetë më e vogël se < 0.5 ms (milisiemens), i cili është kusht për shpëlarjen e mirë të mbushësit.


Pajisjet te cilat pastrohen para çdo fillimi të prodhimit janë:

- a) Gypat e Ujit të Filtruar
- b) Mbushësi i PET-it (Shishe me përmbajtje prej Polietilen terephthalate)
- c) Tanku për përgatitjen e shurupit të sheqerit dhe bufertankut të sheqerit

**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**

- d) Larja e Tankeve të shirupit të çajit të ftohët
- e) Larja e mikserit të aditivëve
- f) Pasterizatorit dhe karbonizerit

Foto Nr. 29. Skema e Procesit të Larjes së Makinerive të Prodhimit të Çajit



### Metodat bazë dhe adaptimi i tyre për përfitimim e produktit cilësor

Pas larjes së gjithë sistemit, i cili është paraqitur në tabelën dhe skemën e sipërme, fillon procesi sterilizimit për të siguruar që sistemi është i pastruar si duhet. Kushtet sanitare në industrinë e ushqimit janë të domosdoshme, pasi është kusht, që pajisjet dhe objekti janë në gjendje higjienike për të parandaluar kontaminimin, e cila mund të çojë në ushqim johigjienik. Prosesi sterilizimit të pajisjeve dhe i tankeve përdor metodën e mbushjes me avull uji, që qarkullojnë për periudhën e kohës deri në një gjendje sterile. Pas ftohjes së tankut me ajër të sterilizuar, fillon procesi përgatitjes së lëndëve të para dhe aditivëve për prodhim sipas hapave të paraqitur më poshtë.

Procesi teknologjik të prodhimit të çajit të ftohët përfshinë: përgatitjen e përbërësve të përzierjes, gatim dhe ambalazhim, si dhe mbushjes së shisheve të pijeve në njësi të paketimit. Në teknologjitë e pijeve joalkoolike rreth 40% të paketimeve përdoren shishe e polietilenit terephthalate (PET). Ato vijnë në paraformë, të cilat pas fryrjes me ajër steril marrin formën përfundimtare për mbushje.

Ajri hyn në fryrës të paraformave pa mikroba, i filtruar nëpërmjet filtrave specifike “Hepa” (High Efficiency Particulate Air/ Filtra me efikasitet të lartë të pastrimit të ajrit).

Filtrat e ajrit mbajnë pluhurin dhe mikroorganizmat në membranat speciale, madhësia e poreve të membranës janë 3 µm, që do të thotë që membrana mban grimcat ≥ 0,3 µm.

Shishe pas marrjes së formës përfundimtare udhëtojnë në rripin transportues ajror për në mbushës, dhe kur ato hyjnë në mbushës, fillon dezinfektimi me përzierje të peroksidit të hidrogjenit dhe acidit citrik. Në mekanizmin rrethor në vazhdim bëhet shpëlarja e tyre me ujë të filtruar me spërkatje në pjesën e brendshme. **Dezinfektim** në industrinë ushqimore, do të thotë mundësia e sigurimit më pak të ndotjes me mikroorganizma patogjene dhe në veçanti mundësia e reduktimit të rritjes së mikroorganizmave ndotës. Pas fryrjes së shisheve për mbushje, ato vazhdojnë rrugën në rripin transportues për në mbushës. Mekanizmi i rrethores është i përfshirë në makinën për mbushje, në të cilën krijohen tri faza të cilat janë: krijimi vakumit, mbushja e shpejtë dhe mbushja e

**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**

ngadaltë dhe më pas, shtohet ajri i sterilizuar apo dyoksidi karbonit. Produkti përfundimtar është pasterizuar para mbushjes në pasterizator.

**Për realizimin e çajit të ftohtë sipas skemës teknologjike të atashuar, 4 komponentët kryesore që marrin pjesë në proces janë: ujë, avulli, ajri i komprimuar dhe më pas produkti përfundimtar.**

### **1. Kompresori**

Kompresori që përdoret për ajër të komprimuar, duhet të jetë i përshtatshëm të punojë me një gamë të gjerë presionesh, pasi ajri i komprimuar merr pjesë njëkohësisht dhe në procesin e realizimit të çajit dhe në procesin e mbushjes dhe të ambalazhimit të tij. Prurja, duhet të jetë e aftë të përballojë kërkesat e paraqitura nga pajisjet e tjera si pasteri, saracineskat pneumatike dhe linja e mbushjes dhe varet nga kërkesat e prodhuesit për këto makineri. Për më tepër, duhet të parashikohet dhe përdorimi i një depozite akumulator presioni për magazinimin e kësaj sasive të ajrit të komprimuar.

Foto Nr. 30. Pamje të Kompresorit



**2. Kaldaja.** Kaldaja përdoret për realizimin e avullit që shfrytëzohet në 2 makineri, në depozitën e përgatitjes së çajit 1000litra dhe në pasterin me kapacitet 1500litra/h. Kaldaja që përdoret duhet të jetë aftë të prodhojë avull me temperaturën nga 95 deri 105 °C. Burimi i nxehtësisë për kaldajën mund të jetë butan, pelet, biomasë apo forma të tjera, por në të gjitha rastet duhet të garantohet njëtrajtshmëria e temperaturës dhe furnizimi automatik.


Foto Nr. 31. Kaldaja



### **3. Pasterizatori**

Foto Nr. 32. Pasterizatori

**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**



Përdoret për pasterizimin e çajit të ftohët në temperaturë 95°C për 30 sec. me ç'ka arrihet efekti i zhdukjes së mikroorganizmave dhe rritet jetëgjatësia e produktit. Eshtë i ndërtuar nga 3 seksione: paraxemjes, nxemjes ( ku arrinë temperaturën e pasterizimit 95°C dhe seksioni i ftohjes. Parashikohet me kapacitet 2000litra/h dhe **duhet të jetë i çertifikuar me 3A, që nën kupton maksimumin e higjenës.** Tepër e nevojshme në pasterizator është përdorimi i një regjistruesi të temperaturës për të garantuar që procesi zhvillohet brenda parametrave të kërkuar.

#### **4. Depozita për përgatitjen e bazës së çajit**

Depozita për përgatitjen e esencës duhet të realizohet me mure të dyfishtë me material inoksi ushqimor AISI 304L dhe finiturë me efekt llustër Mirror Polished BA, me orientim vertikal dhe e përbërë nga 2 mantele, pasi në hapësirën ndërmjet 2 manteleve, do të vendoset serpentina, në të cilën do kalojë avulli i kaldajës për realizimin e procesit. Depozita, do të ketë dhe një mikser për realizimin e përzierjes. Kështu, në temperatura të larta do të realizohet zierja e llojit të çajit që do të prodhohet ose ndryshe fitimi i bazës/ekstraktit të çajit që duhet të prodhohet

Foto Nr.33. Depozita për Përgatitjen e bazës së çajit



#### **5. Depozita e përzierjes finale të çajit**

Pas përgatitjes së bazës, produkti kalon në depozitat 3000litra, të cilat dhe këto janë realizuar me inoks ushqimor AISI 304L dhe finiturë me efekt llustër Mirror Polished BA, të orientuar vertikalisht, të pajisur me mikser dhe bonkaportë, për pastrimin e tyre, ku realizohet përzierja e bazës së çajit me komponentet e tjera dhe finalizimi i shijes së çajit që duhet të prodhohet.

Foto Nr.34



**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**



**6. Linja e realizimit të shisheve PET dhe mbushjes së produktit**

Foto Nr. 35. Makineria për mbushjen e shisheve me çaj dhe makineria e etiketimit



Makineria për nxehjen dhe fryrjen e ambllazhit PET (epruvetave) për të përfituar bidonat ku do të mbushet çaji i ftohtë. Procesi fillon me fryrjen e epruvetave deri ne fitimin e ambllazhes PET me volume të ndryshme ( 0.33, 0.5 dhe 1.5 litra) Ambllazha e përdorur i plotëson standartet për përdorim në industrinë ushqimore dhe do të importohet nga EU.

**7. Linja e mbushjes, mbylljes, etiketimit dhe paketimit në koli.**

Foto Nr. 36



Pastaj çaji i mbushur kalon tek makina për etiketim, ku bëhet shënimi i të dhënave për produktin dhe kompaninë.

**BIO FLORES “ SHPK”, NIPT L93309203B**  
**“LINJË PERPUNIMI DHE PRODHIMI I ÇAJIT TË FTOHTË NGA BIMËT**  
**MEDICINALE”**

